



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), nenin 2, pika 29) dhe nenin 64, paragrafi (3) nga Ligji i Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13, 71/14 dhe 223/15), në pikën 6), pas nënpikës 33), shtohen 11 nënpika të reja 34), 35), 36), 37), 38), 39), 40), 41), 42), 43) dhe 44) që thonë:

"34) **Premia nga instrumentet kapitale të shitura** paraqet diferencë ndërmjet vlerës së shitur dhe vlerës nominale të instrumenteve kapitale. Nëse vlera shitëse e instrumenteve kapitale është më e ulët se vlera nominale e tyre, fitohet premia negative nga instrumentet kapitale të shitura. Nëse vlera shitëse e instrumenteve kapitale është më e lartë se vlera nominale e tyre, fitohet premia pozitive nga instrumentet kapitale të shitura.

35) **Personi nga sektori financiar** është person juridik me seli në Republikën e Maqedonisë ose jashtë që është bankë, institucion financiar jobankar ose shoqëri për shërbime bankare ndihmëse (nëse shoqëria përfshihet në raportet financiare të konsoliduara të bankës), në pajtim me Ligjin e Bankave.

36) **Investimi sintetik** paraqet investim në instrumentet vlera e të cilës është drejtpërdrejt lidhur me vlerën e instrumenteve kapitale të lëshuar nga persona prej sektorit financiar.

37) **Pjesëmarrja jokontrollimit (pakica)** përfshin pozitat nga kapitali bazë i rregullt të filialit që janë në pronësi të palëve të treta që nuk janë anëtare të grupit bankar të cilës i përket banka që është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar.

38) **Kapitali bazë shtesë i pranueshëm dhe kapitali shtesë i pranueshëm** janë pozitat nga kapitali bazë shtesë dhe pozitat nga kapitali shtesë të filialit që janë në pronësi të palëve të treta që nuk janë anëtare të grupit bankar të cilës i përket banka që është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar.

39) **Investim i rëndësishëm** në person nga sektori financiar paraqet investim të bankës që i plotëson kriteret në vijim:

- investimi në bankën tejkalon 10% nga kapitali bazë i rregullt të personit nga sektori financiar;
- banka ka lidhje të ngushta me personin nga sektori financiar, pavarësisht shumës së investimit në instrumentet kapitale të kapitalit të rregullt bazë të atij personi; ose
- banka ka investim në kapitalin bazë të rregullt të personit nga sektori financiar që nuk është anëtare e grupit bankar të cilës i përket banka, por personi nga sektori financiar dhe banka janë subjekt i konsolidimit, në pajtim me rregulloret për kontabilitet dhe standardet e kontabilitetit.

Të gjitha investimet që nuk plotësojnë së paku një nga tre kriteret e mëparshme konsiderohen për investime në **persona nga sektori financiar në të cilën banka nuk ka investim të rëndësishëm**.

40) **Fitimi rrjedhës ose humbja rrjedhëse** është fitim ose humbje nga bilanci i suksesit të bankës, i realizuar gjatë një periudhe kohore më të shkurtër se një vit kalendarik dhe përpara se të merret vendimi për konfirmimin e rezultatit financiar për periudhën nga kuvendi i bankës.

41) **Fitim në fund të vitit ose humbje në fund të vitit** është fitimi ose humbja nga bilanci i suksesit të bankës, i realizuar gjatë një viti kalendarik dhe përpara se të merret vendimi për konfirmimin e rezultatit financiar për vitin nga asambleja e bankës.

42) **Norma e pagesës së dividendës** përcaktohet si raport i dividendës së paguar të aksionerëve të bankës dhe fitimit pas tatimit. Nëse ky raport është negativ ose më i madh se 100%, norma e pagesës së dividendës është e barabartë me 100%. Nëse fitimi pas tatimit është zero, norma e pagesës së dividendës është e barabartë me: (1) 0% nëse nuk ka pasur pagesë të dividendës ose (2) 100%, nëse banka e ka paguar dividendën.

43) **Fitimi i disponueshëm për shpërndarje** përfshin shumën e fitimit pas tatimit, të konfirmuar nga asambleja e bankës ose shuma e fitimit rrjedhës, të cilat i plotësojnë kushtet për shpërndarjen e dividendit ose pagesën e avans-dividentit, në pajtim me ligjin.

44) **Mjete tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës** paraqesin kërkesa në bazë të tatimit të paguar më shumë në pajtim me rregulloren tatimore, që mund ta zvogëlojnë detyrimin tatimor të bankës, vetëm nëse në të ardhmen banka realizoi fitim që është subjekt i tatimit. **Mjete tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rezultojnë nga dallime të herëpashershme** paraqesin kërkesa në bazë të tatimit të paguar më shumë në pajtim me rregulloren tatimore, në bazë të dallimeve të herëpashershme në raport të llogaritjes së detyrimeve në bazë të tatimit.”

2. Kreu **III. MJETE VETANAKE** ndryshohet dhe thotë:

III. MJETET VETANAKE

8. Mjetet vetanake të bankës paraqesin përmbledhje të kapitalit bazë, të përcaktuar në pajtim me kreun III.1 nga ky vendim dhe kapitalit shtesë, i përcaktuar në pajtim me kreun III.2 të këtij vendimi, duke marrë parasysh dispozitat nga krerët III.3 dhe III.4 të këtij vendimi.

9. Pozitat që nuk i plotësojnë kushtet nga ky kapitull nuk mund të përfshihen në llogaritjen e mjeteve vetanake të bankës.

Nëse Banka Popullore përcakton se pozita të caktuara që bank i ka përfshirë në përcaktimin e mjeteve vetanake nuk i plotësojnë kushtet nga ky kapitull, menjëherë do ta udhëzojë bankën t'i përjashtojë ato pozicione nga shuma e mjeteve vetanake. Banka mund t'i përfshijë ato pozicione në përcaktimin e mjeteve vetanake, vetëm pas plotësimit të kushteve të nevojshme dhe pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore.

10. Gjatë përcaktimit të shumës së mjeteve vetanake, banka është e detyruar t'i respektojë normat në vijim:

- kapitalit bazë i rregullt nuk guxon të jetë më i ulët se 4,5% nga aktivi i ponderuar sipas rreziqeve (norma e kapitalit bazë të rregullt);
- kapitali bazë nuk guxon të jetë më i ulët se 6% nga aktivi i ponderuar sipas rreziqeve (norma e kapitalit bazë).

III.1. Kapitali bazë

11. Kapitali bazë i bankës paraqet përmbledhje të kapitalit bazë të rregullt, të përcaktuar në pajtim me kreun III.1.1 të këtij vendimi dhe kapitali bazë shtesë, të përcaktuar në pajtim me kreun III.1.2 të këtij vendimi.

III.1.1 Kapitali bazë i rregullt

12. Kapitali bazë i rregullt fitohet si shumë e pozitave nga pika 13) të këtij vendimi do të zvogëlohet për shumën zërave të zbritshëm të pikës 16) të këtij vendimi dhe do të korrigjohet për harmonizimet rregullator të pikës 19-ë) të këtij vendimi.

13. Në kapitalin bazë të rregullt të bankës përfshihen pozicionet në vijim:

13.1. Instrumentet kapitale që i plotësojnë kushtet nga pika 14) të këtij vendimi dhe për të cilat është marrë pëlqimi nga paragrafi (2) e kësaj pike;

13.2. Preminë nga shitja e instrumenteve kapitale nga nënpika 13.1) e kësaj pike;

13.3. Rezerva e përgjithshme e detyrueshme (fondi rezervë i përgjithshëm);

13.4. Fitimi i mbajtur i pashpërndarë që nuk rëndohet me çfarëdolloj detyrim të ardhshëm, i cili shënohet në bilancin e gjendjes së bankës dhe është konfirmuar me vendim të asamblesë së aksionarëve të bankës. Vendimi duhet të përmbajë dispozitë që parasheh se fitimi i mbajtur nuk do të jetë i disponueshëm për pagesën e dividendës së aksionarëve në të ardhmen. Në këtë pozicion përfshihet edhe humbja e akumuluar nga vitet e mëparshme, me shenjë negative;

13.5. Fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit që i plotësojnë kushtet e pikës 15) të këtij vendimi; dhe

13.6. Fitimi ose humbja totale e përgjithshme që i përfshin fitimet dhe humbjet e tjera që nuk janë paraqitur në bilancin e suksesit të bankës.

Pozicionet nga nënpika 13.1) nga paragrafi (1) i kësaj pike përfshihen në kapitalin bazë të rregullt vetëm pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore. Banka është detyruar të paraqesë dokumentacionin nga i cili mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në pikën 14) të këtij vendimi, së paku 30 ditë para synimit për përfshirjen e këtyre instrumenteve në llogaritjen e mjeteve vetanake.

Banka Popullore vendos për kërkesën e parashtruar për dhënien e pëlqimit nga paragrafi (2) e kësaj pike, në afat prej 30 ditësh pas plotësimit të dokumentacionit me të cilën konfirmohen kushtet e pikës 14) të këtij vendimi.

Pozicionet nga nënpikat 13.3, 13.4, 13.5 dhe 13.6 nga paragrafi 1 e kësaj pike duhet të jenë plotësisht dhe menjëherë në dispozicion për të mbuluar rreziqet dhe humbjet gjatë funksionimit të bankës.

14. Intrumentet kapitale që i plotësojnë kushtet në vijim mund të jenë pjesë e kapitalit bazë të rregullt:

14.1. Të lëshuara janë nga banka në bazë të vendimit të asamblesë së aksionarëve;

14.2. Të paguara janë plotësisht, me ç'rast banka nuk guxon ta financojë blerjen e tyre, drejtpërdrejtë ose tërthorazi;

14.3. Kanë trajtim të kapitalit aksionar, në pajtim me rregulloret për kontabilitet dhe standardet e kontabilitetit që vlejnë për bankat edhe janë plotësisht dhe në dispozicion të pakufizuara për të mbuluar humbjet;

14.4. Në bilancin e gjendjes së bankës janë paraqitur qartë dhe ndaras;

14.5. Ato janë të pakushtëzuara të pakthyeshme, nuk kanë afat të maturimit dhe nuk mund të blihen, të shlyhen, gjegjësisht nuk mund të ulet vlera, me përjashtim të falimentimit ose likuidimit të bankës ose pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-h) të këtij vendimi. Si përjashtim, kushtet e këtij nënseksioni do të konsiderohen të plotësuar nëse rënia e vlerës ka ndodhur si rezultat i një mase të ndërmarrë nga Banka Popullore, në bazë të ligjit;

14.6. Nuk përmbajnë klauzola ose lloj tjetër të dispozitave që japin mundësi për blerjen e tyre, shlyerjen ose uljen e vlerës së tyre, me përjashtim të falimentimit ose likuidimit të bankës, as banka gjatë lëshimit të tyre, inkurajoi çdo pritshmëri për blerjen e tyre, shlyerjen ose uljen e vlerës së tyre;

14.7. Janë plotësuar kushtet në vijim në raport të tarifës që mund t'u shpërndahet mbajtësve të instrumenteve kapitale:

- nuk ekziston prioritet në pagesën e tarifës, përfshirë edhe në raport me instrumentet tjera që janë pjesë nga kapitali bazë i rregullt;
- pagesa e tarifës mund të kryhet vetëm nga fitimi e disponueshme për shpërndarje;
- nuk janë parashikuar dispozita me të cilat kufizohet lartësia maksimale e tarifës;
- shuma e tarifës nuk varet nga çmimi pas së cilës mbajtësit i kanë blerë këto instrumente gjatë lëshimit të tyre;
- nuk ekziston obligim i detyrueshëm për pagesë të rregullt të tarifës;
- anulimi i pagesës së tarifës nuk konsiderohet për pamundësi banka t'i shlyejë detyrimet e veta;
- dorëheqja e pagesës së tarifës nuk shkakton kufizime për bankën për pagesë për arsye tjera.

14.8. Kanë kualitet më të lartë në raport me instrumentet kapitale të bankës, gjegjësisht përdoren së pari për të mbuluar humbjet gjatë funksionimit të bankës dhe çdo instrument kapital që është pjesë e kapitalit bazë të rregullt në mënyrë proporcionale dhe e barabartë, gjegjësisht pari passu, përdoret për të mbuluar humbjet. Konsiderohet se ky kusht është plotësuar edhe në rastet e fshirjes së përhershme të kryegjësë të instrumenteve kapitale që janë pjesë nga komponentët tjerë të mjeteve vetanake;

14.9. Në rast falimentimi ose likuidimi të bankës këto instrumente paguhen të fundit në raport të të gjitha detyrimeve të tjera të bankës ndaj kreditorëve të tjerë;

14.10. Në rast falimentimi ose likuidimi të bankës, mbajtësit e këtyre instrumenteve kanë të drejtë të arkëtimit nga pjesa tjetër e aktivit të bankës që do të mbetet pas pagesës së detyrimeve tjera, me ç'rast e drejta për arkëtim është proporcionalisht në pjesëmarrjen e instrumenteve të lëshuara dhe shuma maksimale e arkëtimit nuk është fikse ose e kufizuar;

14.11. Nuk janë siguruar ose mbuluar me çfarëdo garancie nga banka ose personi lidhur me të, me çka do të ullej shkallën e subordinimit të këtyre instrumenteve që është përcaktuar në nënpikat 14.8),

14.9 dhe 14.10) e kësaj pike;

14.12. Nuk i nënshtrohet çfarëdo përgjigje që e ul shkallën e subordinimit të instrumentit që është i përcaktuar në nënpikat 14.8), 14.9) dhe

14.10 nga kjo pikë, në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës.

15. Fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit mund të përfshihen në përlogaritjen e kapitalit bazë të rregullt të bankës vetëm në bazë të pëlqimit të marrë nga Banka Popullore.

Shuma e fitimit rrjedhës ose fitimit në fund të vitit zvogëlohet për shumën e avansit të paguar të dividendës dhe/ose dividendës për të cilën ka vendim nga bordi mbikëqyrës i bankës se do të shpërndahet në aksionerët e saj. Nëse bordi mbikëqyrës nuk ka miratuar vendim për pagesën e dividendës, fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit zvogëlohet me shumën më të lartë si vijojnë:

- dividendën e përcaktuar në bazë të normës së pagesës së dividendës në pajtim me politikën e dividendës të bankës;
- dividendën e përcaktuar në bazë të normës mesatare të dividendës për tre vitet e fundit;
- dividendën e përcaktuar në bazë të normës së pagesës së dividendës nga viti i fundit.

Banka Popullore do ta lëshojë pëlqimin nga paragrafi (1) i kësaj pike nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- shumën e fitimit rrjedhës ose fitimit në fund të vitit konfirmohet nga një shoqëri për rishikim;
- shumën e fitimit rrjedhës ose fitimit në fund të vitit zvogëlohet me çdo pagesë të bazuar në dividendë, taksa ose detyrime të tjera të ngjashme që paguhen nga fitimi;
- bordi mbikëqyrës i bankës ka marrë vendim që parasheh se fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit nuk do të mund të përdoret për pagesën e dividendit të aksionerëve.

Për vërtetimin e kushtit nga paragrafi (3), nënparagrafi (1) e kësaj pike banka është e detyruar të dorëzojë:

- për fitimin në fund të vitit - raport mbi rishikimin e kryer, i përgatitur në pajtueshmëri me rregulloret e rishikimit, ose letër nga revizori se revizioni i raporteve financiare vjetore është në vazhdim e sipër, por revizori nuk ka ardhur deri te informacionet të cilin raporti përfundimtar do të përmbante mendim të kualifikuar;
- për fitimin rrjedhës - raport për revizionin e kryer ose raport mbi verifikimin e informacioneve mesperiodeke financiare të përpunuar në pajtim me rregulloret e revizionit, ose letër nga revizori që revizioni i raporteve financiare është në vazhdim e sipër, por revizioni nuk ka ardhur në ndonjë dijeni për çka raporti përfundimtar do të përmbante mendim të kualifikuar.

Për vërtetimin e kushtit nga paragrafi (3), nënparagrafi (2) e kësaj pike banka është e detyruar të dorëzojë:

- deklaratë të nënshkruar nga personi i duhur me të drejta të veçanta dhe përgjegjësi në bankë se të hyrat dhe shpenzimet janë paraqitur në bilancin e suksesit në pajtim me rregulloret për kontabilitet dhe standardet e kontabilitetit që vlejnë për bankat;
- deklaratë të nënshkruar nga anëtarët e bordit drejtues të bankës në të cilën veçmas janë paraqitur të gjitha pozicionet e fitimit rrjedhës ose të fitimit në fund të vitit, duke përfshirë edhe pagesat në bazë të dividendës, tatimit ose lloj tjetër detyrime të ngjashme që paguhen nga fitimi.

Banka Popullore vendos për kërkesën e paraqitur për dhënien e pëlqimit nga paragrafi (1) i kësaj pike, në afat prej 30 ditësh pas plotësimit të dokumentacionit me të cilën vërtetohen kushtet e kësaj pike.

Shuma e fitimit rrjedhës për të cilën është marrë pëlqimi nga paragrafi (1) i kësaj pike mund të përfshihet në përllogaritjen e kapitalit bazë në periudhat vijuese të vitit kalendarik aktual, vetëm nëse fitimi është arritur deri në datën për të cilën konstatohet se kapitali bazë është më i madh se shuma e fitimit rrjedhës për të cilin është marrë pëlqim nga Banka Popullore.

16. Kapitali i rregullt bazë zvogëlohet për zërat e zbritshëm në vijim:

16.1. Humbje në fund të vitit ose humbje rrjedhëse;

16.2. Mjetet jo-materiale. Shuma e zërave të zbritshëm zvogëlohet nga detyrimet tatimore të shtyra që do të shuheshin nëse mjetet jo-materiale do të zhvlerësoheshin ose çregjistroheshin, në pajtim me rregulloret e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit që vlejné për bankat. Shuma e zërave të zbritshëm rritet nga vullneti i mirë nga investimet e rëndësishme të bankës;

16.3. Mjete tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës. Shuma e zërit të zbritshëm zvogëlohet për detyrimet tatimore të shtyra vetëm nëse banka, në pajtim me ligjin, ka të drejtë t'i netojë mjetet tatimore rrjedhëse me detyrimet tatimore rrjedhëse. Gjatë përcaktimit të kapitalit bazë të rregullt në bazë të konsoliduar, detyrimet tatimore të shtyre mund ta zvogëlojnë shumën e mjeteve tatimore të shtyra, vetëm nëse mjetet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra i referohen tatimeve që arkëtohen nga institucioni tatimor i njëjtë dhe i referohen subjektit tatimor të njëjtë. Në detyrimet tatimore të shtyra që mund të përfshihen në netimin e mjeteve tatimore të shtyra nuk përfshihen detyrimet tatimore të shtyra nga nënpika 16.2) e kësaj pike;

16.4. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale vetanake nga kapitali bazë i rregullt, duke përfshirë edhe instrumentet kapitale për të cilat banka ka detyrim kontraktual për të blerë. Shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pozicionin afatgjatë të bankës në instrumentet kapitale vetanake nga kapitali bazë i rregullt dhe mund të reduktohet për shumën e pozicionit të shkurtër në këto instrumente vetëm nëse: (1) pozicioni i gjatë dhe i shkurtër janë në të njëjtin instrument edhe pozicioni i shkurtër nuk e ekspozon bankën në rrezik nga pala tjetër kontraktuese dhe (2) të dy pozicionet (i gjatë dhe i shkurtër) janë ose pjesë e portofolit për tregtim ose pjesë e portofolit të aktiviteteve bankare. Në rastin e investimeve në indeks të bursës në të cilën janë përfshirë instrumentet kapitale të bankës, shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pjesëmarrjen proporcionale të këtyre instrumenteve kapitale në indeksin. Nëse banka ka edhe pozicion të gjatë dhe të shkurtër në indeks të bursës në të cilën janë përfshirë instrumentet kapitale të bankës, pozicioni i gjatë mund të ulet për shumën e pozicionit të shkurtër, duke përfshirë edhe pozicion e shkurtër që e ekspozon banka në rrezik të palës tjetër kontraktuese, vetëm nëse: (1) pozicioni i gjatë dhe i shkurtër janë në të njëjtin indeks dhe (2) dhe të dyja pozicionet (i gjatë dhe i shkurtër) janë ose pjesë nga portofoli për tregtim ose pjesë nga portofoli i aktiviteteve bankare.

16.5. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar, me ç'rast ato

persona kanë investime në bankë që në mënyrë artificiale i rrisin mjetet e veta. Shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pozicionin afatgjatë bruto të bankës në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i këtyre personave;

16.6. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar në të cilën banka nuk ka investim të rëndësishëm. Shuma e totalit të zërit të zbritshëm për këto investime është e barabartë me produktin e:

- investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale që janë pjesë nga mjetet vetanake të personave nga sektori financiar në të cilën banka nuk ka investim të rëndësishëm, shuma totale e së cilës tejkalon 10% nga kapitali bazë i rregullt i bankës. Për nevojat e këtij paragrafi, kapitali bazë i rregullt i bankës fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 13) e këtij vendimi do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë) të këtij vendimi dhe do të ulet për zërat zbritshëm nga nënpikat 16.1), 16.2), 16.3), 16.4), 16.5), 16.10) dhe 16.11) e kësaj pike, me përjashtim të shumës së mjeteve tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rezultojnë nga dallime të herëpashershme, dhe

- shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt të personave nga sektori financiar në të cilën banka nuk ka investim të rëndësishëm, pjesëtuar me shumën totale të investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale që janë pjesë nga mjetet vetanake të personave nga sektori financiar në të cilën banka nuk ka investim të rëndësishëm.

Në përcaktimin e shumave nga paragrafët (1) dhe (2) të kësaj nënpike nuk përfshihen investimet direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente kapitale të personave nga sektori financiar në të cilët banka nuk ka investim të rëndësishëm, të cilat mbahen deri në pesë ditë. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike nga paragrafi (1) të kësaj nënpike që nuk tejkalon 10% nga kapitali bazë i rregullt përfshihet në përcaktimin e aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi;

16.7. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar në të cilën banka ka investim të rëndësishëm, me përjashtim të atyre që mbahen deri në pesë ditë;

16.8. Shuma e zërave të zbritshëm nga kapitali bazë shtesë nga pika 19-c) të këtij vendimi, që e tejkalon shumën totale të kapitalit bazë shtesë nga pika 19) e këtij vendimi;

16.9. Investime në institucione jofinanciare. Shuma e zërit të zbritshëm e paraqet shumën e tejkallimit të kufijve nga Ligji i Bankave që i referohen pjesës individuale të kapitalit (15%) dhe agregate, gjegjësisht shumës totale të pjesëve kapitale në institucionet jofinanciare (30%). Nëse banka tejkalon një nga kufijtë e shënuar, si zëri i zbritshëm merret shuma e tejkallimit të kufirit. Nëse banka tejkalon edhe dy kufijtë e shënuar, si zëri i zbritshëm merret shuma më e madhe e tejkallimit të të dy kufijve. Në kuadër të këtyre kufijve nuk merren parasysh investimet që mbahen deri në pesë ditë, si dhe letrat me vlerë që korrespondojnë në emër të bankës, dhe për llogari të subjekteve tjera;

16.10. Kosto për tatim që mund të përcaktohen në momentin e llogaritjes, përveç nëse banka tashmë në mënyrë të duhur nuk e ka përshtatur shumën e

pozicioneve që hyjnë në kapitalin bazë të rregullt deri në nivelin ku kostot për tatim do të ulnin shumën e disponueshme për mbulimin e rreziqeve ose humbjeve;

16.11. Dallimi ndërmjet korrigjimit të vlerës dhe rezervës së veçantë e përcaktuar nga banka dhe shuma e nevojshme e korrigjimit të vlerës së rezervës së veçantë, në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin me rrezikun e kredisë.

17. Shuma e zërave të zbritshëm nga pika 16), nënpikat 16.6), dhe 16.7), të këtij vendimi është e barabartë me pozicionin afatgjatë bruto të bankës në këto investime dhe mund të ulet për shumën e pozicionit të shkurtër në ato investime vetëm nëse pozicioni i gjatë dhe i shkurtër i referohen instrumentit të njëjtë, ku: (1) pozicioni i gjatë dhe i shkurtër kanë maturim të njëjtë ose maturimi i mbetur i pozicionit të shkurtër është së paku një vit dhe (2) dhe të dyja pozicionet (i gjatë dhe i shkurtër) janë ose pjesë nga portofoli për tregtim ose pjesë nga portofoli i aktiviteteve bankare. Në rastin e investimeve në indeks të bursës në të cilën janë përfshirë instrumentet kapitale të personave nga sektori financiar, shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pjesëmarrjen proporcionale të atyre instrumenteve kapitale në indeksin.

Banka nuk është e obliguar t'i përfshijë si zëra të zbritshëm pozicionet në vijim nga pika 16), nënpika 16.3), dhe 16.7), të këtij vendimi, nëse shuma e tyre nuk e tejkalon kufirin nga paragrafi (3) e kësaj pike:

- mjete tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rezultojnë nga dallime të herëpashershme, shuma totale e së cilës nuk tejkalon 10% nga kapitali bazë i rregullt i bankës i përcaktuar kur shuma e pozicioneve nga pika 13) të këtij vendimi do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë) të këtij vendimi dhe do të ulet për zërat e zbritshëm nga pika 16), nënpikat 16.1),, 16.2),, 16.3),, 16.4),, 16.5),, 16.6),, 16.10), dhe 16.11), të këtij vendimi, me përjashtim të shumës së mjeteve tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rezultojnë nga dallime të herëpashershme; dhe

- investimet direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar në të cilën banka ka investim të rëndësishëm, shuma totale e së cilës nuk tejkalon 10% nga kapitali bazë i rregullt i bankës i përcaktuar kur shuma e pozicioneve nga pika 13) të këtij vendimi do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë) të këtij vendimi dhe do të ulet për zërat e zbritshëm nga pika 16), nënpikat 16.1),, 16.2),, 16.3),, 16.4),, 16.5),, 16.6),, 16.10), dhe 16.11), të këtij vendimi, me përjashtim të shumës së mjeteve tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rezultojnë nga dallimet e herëpashershme.

Për nevojat e paragrafit 2 e kësaj pike, kufiri përcaktohet si produkt i:

- shumës së kapitalit bazë të rregullt të bankës që fitohet si shumë e pozicioneve nga pika 13 të këtij vendimi do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë të këtij vendimi dhe do të ulet për zërat e zbritshëm nga pika 16 të këtij vendimi; dhe

- 17,65%.

Pozicionet nga paragrafi (2) i kësaj pike që nuk janë zëri i zbritshëm nga kapitali bazë i rregullt përfshihen në përcaktimin e aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut të kredisë me ponder të rrezikut prej 250%.

III.1.2. Kapitali bazë i shtuar

18. Kapitali bazë i shtuar fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 19 të këtij vendimi do të zvogëlohet për shumën zërave të zbritshëm të pikës 19-c të këtij vendimi dhe do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore të pikës 19-ë të këtij vendimi.

19. Në kapitalin bazë shtesë të bankës përfshihen pozicionet në vijim:

- instrumentet kapitale që i plotësojnë kriteret 19-a të këtij vendimi; dhe
- preminë nga shitja e instrumenteve kapitale nga nënpika 1) e kësaj pike.

19-a. Intrumenetet kapitale që i plotësojnë kushtet në vijim mund të jenë pjesë e kapitalit bazë të shtuar:

19-a.1. Të lëshuara dhe të paguara janë plotësisht, me ç'rast banka nuk e financon blerjen e tyre, direkt ose indirekt;

19-a.2. Nuk janë të blera nga banka, filiali i saj ose personi në të cilën banka ka pjesëmarrje;

19-a.3. Në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës paguhen pas instrumenteve që janë pjesë nga kapitali shtesë i bankës;

19-a.4. Nuk janë siguruar ose mbuluar me çfarëdo garancie nga banka ose personi lidhur me të, me çka do të ulëj shkalla e subordinimit të këtyre instrumenteve që është përcaktuar në nënpikat 19-a.3 e kësaj pike;

19-a.5. Nuk i nënshtrohen çfarëdolloj përgjigje që e ul shkallën e subordinimit që është i përcaktuar në nënpikën 19-a.3 e kësaj pike, në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës;

19-a.6. Nuk kanë afat të maturimit;

19-a.7. Në rastet kur janë paraparë një ose më shumë opsione për blerje ose shlyerje të instrumentit, shfrytëzimi i opsionit për blerje ose shlyerje është e drejtë diskrete vetëm e emetuesit;

19-a.8. Mund të blihen ose shlyhen nga banka vetëm pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-h) të këtij vendimi.

19-a.9. Nuk ekzistojnë klauzola ose lloj tjetër dispozitash për shkak të cilëve do të pritej instrumentet të mund të blehen ose shlyhen përveç në rast të falimentimit dhe likuidimit ose pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-h të këtij vendimi;

19-a.10. Banka nuk inkurajon pritjen se Banka Popullore do ta lëshon pëlqimin e nevojshëm për blerje ose shlyerje të instrumenteve;

19-a.11. Janë plotësuar kushtet në vijim në raport të tarifës që mund t'u shpërndahet mbajtësve të instrumenteve kapitale:

- pagesa e tarifës bëhet nga fitimi i disponueshëm, me ç'rast pagesa e tarifës mund të kryhet dhe nëse fitimi nuk është rishikuar nga auditori i autorizuar;
- lartësia e tarifës nuk duhet të ndryshohet pavarësisht aftësisë kreditore të bankës ose sërish nga aftësia kreditore të personit amë të saj;
- banka ka diskrecion të plotë në çdo kohë të anulojë pagesën e tarifës për

periudhë të pakufizuar dhe në bazë jokumulative dhe pa kufizime të përdorë tarifën e papaguar për plotësimin e detyrimeve të tij;

- anulimi i pagesës së tarifës nuk konsiderohet për pamundësi banka t'i shlyejë detyrimet e veta;
- anulimi i pagesës së tarifës nuk e kufizon bankën të kryejë pagesë mbi baza tjera;

19-a.12. Nuk merren parasysh gjatë përcaktimit nëse janë plotësuar kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit, në pajtim me ligjin;

19-a.13. Përmbajnë dispozita me të cilat është përcaktuar se në rast të ndodhjes ngjarje kritike, shlyhet, gjegjësisht ulet vlera e kryegjësë së këtyre instrumenteve në bazë të përhershme ose të përkohshme ose instrumenti konvertohet në instrument nga kapitali bazë i rregullt;

19-a.14. Instrumenti nuk guxon të ketë karakteristika që mund të vështirësojnë rikapitalizimin e bankës;

19-a.15. Në rastet kur instrumenti nuk është lëshuar direkt nga banka: (1) ai është lëshuar nga personi që është anëtar i grupit bankar të cilës i përket banka dhe (2) mjetet monetare të paguara janë menjëherë të disponueshme dhe në dispozicion të bankës pa kurrfarë kufizimi, me ç'rast janë plotësuar të gjitha kushtet të parapara në këtë pikë;

19-a.16. Instrumenti kapital nuk ka trajtim të depozitit (depozitë kursimi) dhe nuk është subjekt i sigurimit nga Fondi për Sigurimin e Depozitave.

19-b. Për plotësimin e kushteve nga pika 19-a), nënpika 19-a.11), nënparagrafi (5) dhe nënpika 19-a.14) të këtij vendimi, është e nevojshme instrumenti të mos përmbajë dispozita me të cilat parashihet: (1) pagesë e detyrueshme e tarifës në rast të pagesës së tarifës për instrumente me cilësi të njëjtë ose më të mirë, duke përfshirë instrumentet nga kapitali bazë i rregullt, (2) anulimi i detyrueshëm i pagesës së tarifës për instrumentet e tjera nga kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë dhe kapital shtesë, nëse nuk kryhet pagesa e tarifës për instrumentin; (3) detyrimi për zëvendësim të pagesës së interesit ose dividendit me çfarëdo formë tjetër të tarifës.

Për plotësimin e kushtit nga pika 19-a, nënpika 19-a.13) të këtij vendimi, është e nevojshme kontrata për instrumentin t'i përmbajë dispozitat në vijim:

- ngjarja kritike është definuar si ulje e normës së kapitalit bazë të rregullt nën 5,125%. Banka mund të përcaktojë edhe nivel më të lartë të ngjarjes kritike ose krahas ngjarjes kritike të përcaktuar kështu, të përcaktojë edhe ngjarje tjera kritike;

- me fshirjen, gjegjësisht me konvertimin krijohen instrumente, gjegjësisht pozicione që mund të jenë pjesë nga kapitali bazë i rregullt, në pajtim me pjesën III.1.1 të këtij vendimi,

- nëse është paraparë konvertimi i instrumentit nga kapitali bazë shtesë në instrumentin kapital nga kapitali bazë i rregullt, dispozitat duhet ta parashohin: (1) raporti i konvertimit dhe shuma maksimale e lejuar mund të konvertohet në instrument nga kapitali bazë i rregullt ose (2) diferenca në kuadër të cilës instrumenti do të konvertohet në instrument nga kapitali bazë i rregullt, duke pasur parasysh lëvizjen e çmimeve të instrumenteve;

- nëse është paraparë fshirja, gjegjësisht ulja e vlerës së kryegjësë të instrumentit nga kapitali bazë shtesë, ulja i referohet: (1) kërkesat të cilat do ti

kishte mbajtësi i instrumentit, në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës; (2) shuma që duhet të paguhet në rast të aktivizimit të opsionit për revokim ose pagesë të instrumentit dhe (3) tarifa nga instrumenti.

Shuma totale e instrumenteve nga kapitali bazë shtesë që fshihet ose konvertohet në instrumente nga kapitali bazë i rregullt pas ndodhjes së ngjarjes kritike nuk mund të jetë më e vogël se shuma më e ulët ndërmjet: (1) shuma e nevojshme për arritjen e normës së kapitalit bazë të rregullt prej 5,125% dhe (2) e gjithë shuma e kryegjësë së instrumentit.

Në rast të ndodhjes së ngjarjes kritike, banka duhet:

- 1) menjëherë ta informon Bankën Popullore;
- 2) t'i informon mbajtësit e instrumenteve; dhe
- 3) ta fshin kryegjënë e instrumenteve, ose t'i konvertojë në pozicione nga kapitali bazë i rregullt, jo më gjatë se 30 ditë nga ngjarja kritike.

Banka është e detyruar:

- Vazhdimisht të posedon aksione të zakonshme në shumë që është i mjaftueshëm për konvertimin e instrumenteve nga kapitali bazë shtesë në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt;
- në datën e lëshimit të instrumenteve nga kapitali bazë shtesë t'i sigurojë të gjitha miratimet e nevojshme nga organi kompetent përkatës, në pajtim me ligjin;
- në çdo kohë të disponon me miratimet e nevojshme nga organi kompetent përkatës për lëshim të instrumenteve nga kapitali bazë i rregullt përmes konvertimit të instrumenteve nga kapitali bazë shtesë, në pajtim me ligjin.

Në rast të fshirjes, gjegjësisht uljes së vlerës së kryegjësë, fshirja bëhet në mënyrë proporcionale të të gjitha instrumenteve nga pika 19-a) e këtij vendimi.

Fshirja e instrumenteve nga pika 19-a) e këtij vendimi mund të kryhet në bazë të përkohshme vetëm nëse janë plotësuar kushtet në vijim:

- shuma e tarifës që paguhet pas fshirjes së realizuar llogaritet në shumën e uljes së kryegjësë të instrumentit;
- mund të kryhet rritje e kryegjësë së instrumenteve vetëm nga fitimi pas tatimit, të konfirmuar nga kuvendi i bankës;
- banka ka diskrecion të plotë gjatë vendimarrjes për rritjen e kryegjësë së instrumenteve ose për pagesën e tarifës së shumës së reduktuar të kryegjësë;
- rritja e kryegjësë së instrumenteve kryhet në mënyrë proporcionale me të gjitha instrumentet nga pika 19-a) e këtij vendimi që ishin subjekt i fshirjes në bazë të përkohshme;
- shuma maksimale e rritjes së kryegjësë së instrumenteve së bashku me shumën e tarifës që paguhet në shumën e reduktuar të kryegjësë përcaktohet në datën e rritjes së kryegjësë së këtyre instrumenteve dhe është e barabartë me produktin nga fitimi pas tatimit dhe pjesëmarrjes së shumës nominale (para se të kryhet fshirja) e instrumenteve nga pika 19-a) e këtij vendimi që ishin subjekt i fshirjes në bazë të përkohshme dhe shuma totale e kapitalit bazë të bankës;

- shuma e rritjes së kryegjësë së instrumenteve dhe shuma e tarifës që paguhet në shumën e reduktuar të kryegjësë e zvogëlojnë shumën e kapitalit bazë të rregullt dhe e zvogëlojnë shumën maksimale për shpërndarjen e rezultatit nga funksionimi i bankave.

19-c. Kapitali bazë shtesë zvogëlohet për pozicionet në vijim:

19-c.1. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale vetanake nga kapitali bazë shtesë, duke përfshirë edhe instrumentet kapitale për të cilat banka ka detyrim kontraktual për të blerë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat nga pika 16), nënpika 16.4) të këtij vendimi;

19-b.2. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente kapitale nga kapitali bazë i shtuar i personave nga sektori financiar, me ç'rast ato persona kanë investime në bankë që në mënyrë artificiale rriten mjetet e veta personale. Shuma e zërave të zbritshëm është e barabartë në pozicionin afatgjatë bruto të bankës në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i shtuar të këtyre personave;

19-c.3. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë shtesë i personave nga sektori financiar në të cilën banka nuk ka investim të rëndësishëm. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat nga pika 16), nënpika 16.6), dhe pika 17), paragrafi (1) të këtij vendimi;

19-c.4. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente kapitale nga kapitali bazë i shtuar i personave nga sektori financiar në të cilën banka ka investim të rëndësishëm, me përjashtim të atyre që mbahen deri në pesë ditë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat nga pika 17), nënpika 1) të këtij vendimi;

19-c.5. Shuma e zërave të zbritshëm nga kapitali shtesë nga pika 19-e) e këtij vendimi, e cila tejkalon shumën totale të kapitalit shtesë nga pika 19-d) të këtij vendimi.

19-c.6. Shpenzimet për tatim që mund të përcaktohen në momentin e llogaritjes, përveç nëse banka tashmë në mënyrë të duhur nuk e ka përshtatur shumën e pozicioneve që hyjnë në kapitalin bazë shtesë deri në nivelin ku kostot për tatim do të ulnin shumën e disponueshme për mbulimin e rreziqeve ose humbjeve.

III.2 Kapitali shtesë

19 -ç. Kapitali shtesë i bankës fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 19) e këtij vendimi do të zvogëlohet për shumën zërave të zbritshëm nga pika 19-e) e këtij vendimi dhe do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore të pikës 19-ë) e këtij vendimi.

19-d. Në kapitalin shtesë të bankës përfshihen pozicionet në vijim:

- instrumentet kapitale kreditë subordinative që i plotësojnë kriteret 19-dh) e këtij vendimi; dhe
- preminë nga shitja e instrumenteve kapitale nga nënpika 1) e kësaj pike.

19 -dh. Instrumentet kapitale dhe kreditë subordinative që i plotësojnë kushtet në vijim mund të jenë pjesë nga kapitali i shtuar:

19-dh.1. Të lëshuara janë nga, gjegjësisht i janë miratuar, bankës dhe janë të paguara plotësisht;

19-dh.2. Nuk janë të blera, gjegjësisht nuk janë të miratuara nga banka, filiali i saj ose personi në të cilën banka merr pjesë;

19-dh.3. Blerja ose miratimi i këtyre pozicioneve nuk është financuar direkt ose indirekt nga banka;

19-dh.4. Detyrimet në bazë të këtyre pozicioneve janë plotësisht të caktuara në detyrimet ndaj depozituesve të mbetur dhe kreditorëve të bankës;

19-dh.5. Nuk janë siguruar ose mbuluar me çfarëdo garancie nga banka ose personi lidhur me të, me çka do të ulëj shkalla e subordinimit të këtyre instrumenteve që është përcaktuar në nënpikat 19-dh.4) e kësaj pike;

19-dh.6. Nuk i nënshtrohen çfarëdolloj përgjigje që e ul shkallën e subordinimit, të përcaktuar në nënpikën 19-dh.4 e kësaj pike;

19-dh.7. Kanë afat maturimi prej së paku pesë vitesh;

19-dh.8. Në rastet kur janë paraparë një ose më shumë opsione për blerje ose shlyerje të instrumentit, shfrytëzimi i opsionit për blerje ose shlyerje është e drejtë diskrete vetëm e emetuesit;

19-dh.9. Mund të blihen ose shlyhen nga banka vetëm pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-h) e këtij;

19-dh.10. Nuk përmbajnë klauzola ose lloj tjetër të dispozitave, as banka nuk inkurajon pritshmëri se instrumentet do të blehen ose shlyhen parakohe, përveç në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës;

19-dh.11. Nuk përmbajnë klauzola ose lloj tjetër të dispozitave që i japin të drejtë mbajtësit të këtyre instrumenteve të kërkon shlyerje të përshpejtuar të kërkesave të ardhshme në bazë të interesit ose kryegjësë, përveç në rast të falimentimit ose likuidimit;

19-dh.12. Lartësia e interesit ose dividendës nuk duhet të ndryshohet pavarësisht aftësisë kreditore të bankës ose sërish nga aftësia kreditore të personit amë të saj;

19-dh.13. Në rastet kur nuk janë direkt të lëshuara nga banka, gjegjësisht nuk i janë miratuar direkt bankës: (1) të lëshuar janë nga, gjegjësisht, të miratuara i janë personit që është anëtar i grupit bankar të cilës i përket banka dhe (2) mjetet monetare të paguara janë menjëherë të disponueshme dhe në dispozicion të bankës pa kurrfarë kufizimi, me ç'rast janë plotësuar të gjitha kushtet të parapara në këtë pikë;

19-dh.14. Nuk kanë trajtim të depozitit (depozitë kursimi) dhe nuk janë subjekt i sigurimit nga Fondi për Sigurimin e Depozitave.

Shuma e pozicionit nga paragrafi (1) i kësaj pike që përfshihet në llogaritjen e kapitalit shtesë të bankës gjatë pesë viteve të fundit deri në afatin e tij të maturimit, paraqet produkt të:

- shumës nominale të pozicionit në ditën e parë të pesë viteve të fundit deri në afatin e kontraktuar të maturimit;
- numri i ditëve kalendarike të mbetura nga afati kontraktual i maturimit të pozicionit, pjesëtuar me numrin total të ditëve kalendarike në periudhën e pesë viteve të fundit.

19-e. Kapitali bazë shtesë zvogëlohet për pozicionet në vijim:

19-e.1. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente vetanake nga kapitali shtesë, duke përfshirë edhe instrumentet për të cilat banka ka detyrim kontraktual për të blerë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat nga pika 16), nënpika 16.4) të këtij vendimi;

19-e.2. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet nga kapitali i shtuar i personave nga sektori financiar, me ç'rast ato persona kanë investime në bankë me të cilët në mënyrë artificiale rriten mjetet e veta personale. Shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pozicionin afatgjatë bruto të bankës në pozicionet nga kapitali shtesë i këtyre personave;

19-e.3. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet nga kapitali i shtuar i personave nga sektori financiar në të cilën banka nuk ka investim të rëndësishëm. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat nga pika 16), nënpika 16.6), dhe pika 17), paragrafi (1) i këtij vendimi;

19-e.4. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet nga kapitali i shtuar i personave nga sektori financiar në të cilën banka ka investim të rëndësishëm, me përjashtim të atyre që mbahen deri në pesë ditë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat nga pika 17), paragrafi (1) i këtij vendimi.

III.3 Harmonizimet rregullatore

19-ë. Banka nuk i përfshin pozicionet në vijim në llogaritjen e komponentëve të veçantë të mjeteve vetanake:

- çdo rritje e komponentëve të veçantë të mjeteve vetanake që rrjedh nga pozicionet e sekjuritizimit;
- fitimet ose humbjet nga mbrojtja e rrezikut nga rrjedhat monetare;
- fitimet ose humbjet nga detyrimet që maten sipas vlerës objektive, dhe që janë rezultat i ndryshimeve në aftësinë kreditore të bankës;
- fitimet ose humbjet lidhur me detyrimet në bazë të derivateve që maten sipas vlerës objektive, dhe që janë rezultat i ndryshimeve në aftësinë kreditore të bankës, me ç'rast nuk mund të kryhet netimi i këtyre fitimeve ose humbjeve me ato që rezultojnë nga rreziku i palës tjetër kontraktuese.

Me përjashtim të paragrafit (1), nënparagrafi (3) e kësaj pike, banka mund t'i përfshijë fitimet dhe humbjet nga detyrimet që maten sipas vlerës objektive nëse bëhet fjalë për obligacione që i ka lëshuar banka dhe që janë gjithë kohën të mbuluara me kërkesat e bankës (obligacione të mbuluara), me ç'rast ekziston lidhje e madhe ndërmjet ndryshimeve të vlerës së obligacioneve dhe ndryshimeve të vlerës së kërkesave të mbuluara të bankës, gjegjësisht ndryshimet në vlerën e obligacioneve rezultojnë nga ndryshimet në aftësinë kreditore të bankës.

III.4 Dispozita tjera:

19- f. Para se të përfshihen pozicionet nga pikat 19-a) dhe 19-dh) nga ky vendim në llogaritjen e mjeteve vetanake, banka është e detyruar të njoftojë Bankën Popullore për kushtet në të cilat janë krijuar ato, dhe të dorëzojë dokumentacionin nga i cili do të mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë vendim për pozicionin përkatës, së paku 30 ditë para synimit për përfshirjen e këtyre pozicioneve në llogaritjen e mjeteve vetanake. Përveç kësaj, banka dorëzon edhe:

- llogaritjen e nivelit të mjeteve vetanake dhe norma e përshtatshmërisë së kapitalit para dhe pas përfshirjes së këtyre pozicioneve në llogaritjen e mjeteve vetanake me gjendjen e datës për të cilën raportohet;
- Parashikimi i kapitalit total të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, duke përfshirë edhe shtresat mbrojtëse të kapitalit për tre vitet e ardhshme;
- projekcioni i të ardhurave dhe shpenzimeve të bankës në të cilin merret parasysh efekti i përdorimit të pozicioneve, së paku për tre vitet e ardhshme.

Banka mund në llogaritjen e mjeteve vetanake të mos përfshijë pozicione të caktuara të cilat në pajtim me pikat 16), 19-c) dhe 19-e) të këtij vendimi konsiderohen si zëra të zbritshëm, nëse bëhet fjalë për pozicionet me karakter kohor dhe nëse për atë ka marrë pëlqimin nga Banka Popullore. Në pëlqimin nga Banka Popullore është theksuar periudha në të cilën banka mund të mos i përfshijë ato pozicionet si zëri i zbritshëm në llogaritjen e mjeteve vetanake.

19-g. Tarifa që i paguhet instrumenteve nga kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë i shtuar dhe kapitali i shtuar mund të jetë në formë monetare ose në formë të instrumentit që mund të jetë pjesë nga mjetet vetanake të bankës.

19-dh. Në zërat e zbritshëm nga pika 16), nënpikat 16.5),,, 16.6),,, 16.7),,, pika 19-c), nënpikat 19-c.2), 19-c.3), 19-c.4) dhe pika 19-e), nënpikat 19-e.2), 19-e.3) dhe 19-3.4) të këtij vendimi, banka i përfshin vetëm investimet direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet të personave nga sektori financiar që, në pajtim me rregulloret me të cilat rregullohet funksionimi i këtyre personave, kanë trajtim të kapitalit rregullator.

Të gjitha instrumentet tjera që nuk e plotësojnë kushtin nga paragrafi (1) i kësaj

pike përfshihen në përcaktimin e aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi.

Pozicionet nga paragrafi (1) e kësaj pike, banka i shpërndan në zërat e zbritshëm nga kapitali bazë i rregullt, nga kapitali bazë shtesë ose nga kapitali shtesë, duke marrë parasysh cilësinë e tyre, të përcaktuar në rregulloren përkatëse me të cilën rregullohet funksionimi i këtyre personave.

Nëse në bazë të rregullores me të cilën rregullohet funksionimi i personave nga sektori financiar nuk mund të kryhet shpërndarja nga paragrafi (3) i kësaj pike, pozicionet nga paragrafi (1) i kësaj pike zbriten nga kapitali bazë i rregullt i bankës.

19-h. Pa marrë pëlqimin nga Banka Popullore, banka nuk mund:

- 1) T'i blejë ose të ul vlerën e instrumenteve që janë pjesë nga kapitali bazë i rregullt;
- 2) T'i blejë ose t'i shlyen instrumentet që janë pjesë nga kapitali bazë shtesë,
- 3) T'i blejë ose t'i shlyen pozicionet që janë pjesë nga kapitali shtesë, para afatit të kontraktuar të maturimit.

Me përjashtim të paragrafit (1) i kësaj pike, banka mund të blejë instrumente që janë pjesë nga kapitali bazë i rregullt pa marrë pëlqim nga Banka Popullore, nëse shuma e instrumenteve të blera totale nuk tejkalon 1% nga shuma totale e atij lloji instrumentesh që janë të lëshuara nga banka.

Banka nuk guxon të publikojë uljen e vlerës, blerjen ose shlyerjen e parakohshme të pozicioneve nga paragrafi 1) i kësaj pike, para se të marrë pëlqimin nga Banka Popullore.

Banka Popullore do ta lëshon pëlqimin nga paragrafi (1) i kësaj pike nëse kanë kaluar së paku pesë vjet nga data e lëshimit/miratimit të instrumentit dhe nëse:

- banka e ka zëvendësuar këtë instrument me instrument të ri me cilësi të njëjtë ose më të mirë, me ç'rast kostoja për zëvendësimin nuk e rrezikon kapacitetin e bankës për funksionim fitimprurës ose
- banka mund të dëshmojë se mjetet e veta, pas zvogëlimit të tyre për shkak të aktiviteteve nga paragrafi (1) i kësaj pike, do të jenë mbi nivelin e nevojshëm, duke pasur parasysh dispozitat nga pika 10) e këtij vendimi, kapitali total i brendshëm për mbulimin e rreziqeve dhe shtresave mbrojtëse të kapitalit.

Për nevojat e paragrafit (4), nënparagrafi (1) e kësaj pike, kostoja e zëvendësimit nuk kërcënon kapacitetin e bankës për funksionim fitimprurës nëse kostoja për instrumentin e ri nuk është dukshëm më e lartë se kostoja që banka ka pasur për instrumentin që zëvendësohet, me çka banka do të mund të mbajë ose të rrisë përfitueshmërinë e saj.

Me përjashtim të paragrafit 4 e kësaj pike, Banka Popullore mund të lëshojë pëlqim për blerje ose shlyerje të parakohshme të instrumenteve që janë pjesë nga kapitali bazë shtesë dhe kapitali shtesë dhe para skadimit të pesë viteve nga data e lëshimit/miratimit të tyre, vetëm nëse janë plotësuar kushtet nga paragrafi (4), nënparagrafet (1) dhe (2) e kësaj pike dhe nëse:

- për shkak të ndryshimeve rregullatore këto instrumente do të përjashtoheshin nga mejetet vetanake ose do të shpërndaheshin në pozicione me

cilësi më të ulët;

- janë bërë ndryshime në trajtimin tatimor të këtyre instrumenteve, dhe banka mund të dëshmojë se bëhet fjalë ndryshime të rëndësishme që nuk mund të parashikoheshin në momentin e lëshimit/miratimit të instrumenteve.

Për marrjen e pëlqimit nga paragrafët (4) dhe (6) e kësaj pike, institucioni është i detyruar që së paku tre muaj para zbatimit të aktiviteteve nga paragrafi (1) e kësaj pike, t'i dorëzojë Bankës Popullore së paku:

- arsyetimin e detajuar të arsyeve për zbatimin e aktiviteteve nga paragrafi (1) e kësaj pike;
- parashikimi i nivelit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve për periudhën prej së paku tre vite;
- struktura e mjeteve vetanake para dhe pas zbatimit të aktiviteteve nga paragrafi (1) e kësaj pike;
- parashikimi i profitabilitetit për tre vitet e ardhshme, duke marrë parasysh koston e zëvendësimit të instrumentit;
- vlerësimi i rreziqeve në të cilën është ose mund të jetë e ekspozuar banka dhe vlerësimi nëse mjetet vetanake janë në nivel që mundëson mbulimin e atyre rreziqeve, duke përfshirë edhe rezultatet nga testet e stresit që i kryen banka."

3. Në pikën 40), fjala: "bazë" zëvendësohet me fjalët: "kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë".

4. Në pikën 71), nënparagrafi 6), fjalët: "shuma e kërkesës" zëvendësohen me fjalët: "shuma totale e kërkesës".

5. Në pikën 72), paragrafi 2) pas paragrafit (1), shtohet nënparagraf i ri (2) që thotë:

"-hapësira afariste është në pronësi të debitorit/bashkëkreditorit;"

Nënparagrafet (2),(3) dhe (4) bëhen nënparagrafet (3), (4) dhe (5).Në pikën 80), nënparagrafi (1) fjala: "bazë" zëvendësohet me fjalët "kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë".

6. Në pikën 108), paragrafi (3) fjala: "bazë" zëvendësohet me fjalët: "kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë".

7. Në pikën 220), paragrafi (2), nënparagrafi (1) ndryshon dhe thotë:

"-shuma e jokontrrollimit (pakica) pjesëmarrja dhe shumat e kapitalit bazë shtesë të pranueshëm, kapitali bazë i pranueshëm, kapitali shtesë i pranueshëm dhe mjete vetanake të pranueshme të filialit të bankës në pajtim me pikat 220-a) dhe 220-b) të këtij vendimi;

Paragrafi (3) ndryshohet dhe thotë:

"Pozicionet nga paragrafi (2) i kësaj pike janë pjesë përbërëse të kapitalit bazë të rregullt, kapitalit bazë shtesë dhe kapitalit shtesë të grupit bankar. Nëse këto pozicione kanë vlerë negative, paraqesin zë të zbritshëm të kapitalit bazë të rregullt, kapitalit bazë shtesë dhe kapitalit shtesë, respektivisht".

8. Pas pikës 220, shtohen dy pika të reja 220-a) dhe 220-b) dhe bëhen:

"220-a. Pjesëmarrja e jokontrollimit (pakica), kapitali bazë shtesë i pranuar, kapitali bazë i pranuar, kapitali shtesë i pranuar dhe mjetet vetanake të pranuar përbëhen nga pozicionet e kapitalit bazë të rregullt, pozicionet nga kapitali bazë i shtuar dhe pozicionet nga kapitali shtesë i filialit të bankës, respektivisht, që i përkasin palëve të treta.

Pjesëmarrja e jokontrollimit (pakica) dhe shumat e kapitalit bazë shtesë të pranuar, kapitalit bazë i pranuar dhe kapitali shtesë i pranuar i filialit përfshihen në pjesën përkatëse të mjeteve vetanake të bankës në bazë të konsoliduar, nëse:

- filiali është bankë;
- filiali është anëtar i grupit bankar të cilës i përket banka që është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar;
- palët e treta që kanë investuar në pozicionet që janë pjesë nga mjetet vetanake të filialit të bankës nuk janë anëtare të grupit bankar të cilës i përket banka që është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar.

Pjesëmarrja e jokontrollimit (pakica) dhe shumat e kapitalit bazë të shtuar të pranuar, kapitali bazë i pranuar dhe kapitali shtesë i pranuar i filialit që janë direkt ose indirekt të financuara nga banka (personi amë) ose nga filiali i saj, nuk mund të përfshihen në përcaktimin e mjeteve vetanake të bankës në bazë të konsoliduar.

220-b. Shuma e pjesëmarrjes së jokontrollimit (pakica) e filialit që mund të përfshihet në kapitalin bazë të rregullt të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me produktin e:

- 1) shumës më të ulët prej:
 - shumës së kapitalit bazë të rregullt të filialit i nevojshëm për mbulimin e nivelin të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10) të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;
 - shumës së kapitalit bazë të rregullt të filialit që duhet ta mbaj për nevojat e përcaktimit të kapitalit bazë të rregullt në bazë të konsoliduar për shkak të mbulimit të nivelit të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10) të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;
- 2) raporti ndërmjet shumës së kapitalit të rregullt bazë që u përket palëve të treta që kanë investime në filialin dhe shuma totale e kapitalit të rregullt bazë të filialit, e shprehur në përqindje.

Shuma e kapitalit bazë të pranuar të filialit që mund të përfshihet në mjetet vetanake të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me produktin e:

- 1) shumës më të ulët prej:
 - shumës së kapitalit bazë të filialit i nevojshëm për mbulimin e nivelit të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10) të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;
 - shumës së kapitalit bazë të filialit që duhet të mbajë për nevojat e përcaktimit të kapitalit bazë në bazë të konsoliduar për shkak të mbulimit të nivelit të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10) të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;

2) raporti ndërmjet shumës së kapitalit bazë që i përket palëve të treta që kanë investime në filialin dhe shuma totale e pozicioneve të kapitalit bazë të filialit, i shprehur në përqindje.

Shuma e kapitalit bazë shtesë të pranuar të filialit që përfshihet në kapitalin bazë të shtuar të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me dallimin ndërmjet shumës së kapitalit bazë të pranuar nga paragrafi (2) e kësaj pike dhe shuma e pjesëmarrjes pakicë nga paragrafi (1) e kësaj pike.

Shuma e mjeteve vetanake të pranura të filialit që mund të përfshihet në mjetet vetanake të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me produktin e:

1) shumës më të ulët prej:

- shumës së mjeteve vetanake të filialit të nevojshëm për mbulimin e nivelit të përcaktuar me ligj, kapitali total i brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;

- shumës së mjeteve vetanake të filialit që duhet të mbajë për nevojat e përcaktimit të mjeteve vetanake në bazë të konsoliduar për shkak të mbulimit të nivelit të përcaktuar me ligj, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;

2) raporti ndërmjet shumës së mjeteve vetanake të palëve të treta që kanë investime në filialin dhe shuma totale e pozicioneve të mjeteve vetanake të filialit, i shprehur në përqindje.

Shuma e kapitalit bazë shtesë të pranuar të filialit që përfshihet në kapitalin bazë të shtuar të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me dallimin ndërmjet shumës së mjeteve vetanake të pranura nga paragrafi (4) e kësaj pike dhe shuma e kapitalit bazë të pranuar nga paragrafi (2) e kësaj pike.”

9. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Veriut”, dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 mars 2017.

Me përjashtim të paragrafit (1) e kësaj pike, dispozitat e pikës 4) e këtij vendimi do të fillojnë të zbatohen nga 1 qershor 2017.

10. Aksione të zakonshme, mjetet e paguara menjëherë (për kursimoret që nuk janë të bazuara si shoqëri aksionare), të regjistruara dhe të paguara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shpërndahen si pozicione nga kapitali bazë i rregullt dhe nuk nevojitet pëlqim nga Banka Popullore.

11. Kontratat për instrumentet e kapitalit hibrid dhe kontratat për instrumentet e subordinuara, të lidhura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe aksionet prioritare kumulative, të regjistruara dhe të paguara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shpërndahen në kapitalin shtesë.

Nëse banka bën ndryshime në kontratat për instrumentet nga paragrafi (1) e kësaj pike, me të cilat mundësohet plotësimi i kushteve për përfshirjen e tyre në pozicione nga kapitali bazë shtesë, është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore dhe të dorëzojë dokumentacionin nga i cili mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë vendim, së paku 30 ditë para synimit për përfshirjen e këtyre instrumenteve në kapitali bazë shtesë.

V nr. 02-15/XIV-1/2016
15 dhjetor 2016
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Димитар Богов